

PËRMBLEDHJE

Nga fshati në qytet. Proçesi i adaptimit të migrantëve të brendshëm në Shqipëri.

Ky disertacion ekzaminon proçesin e adaptimit të migrantëve të brendshëm të ardhur prej zonave rurale drejt atyre urbane dhe kryesisht në Tiranë. Proçesi i adaptimit të migrantëve të brendshëm në Shqipëri rezulton të jetë një fenomen po aq kompleks dhe i larmishëm sa dhe proçesi i integritimit të emigrantëve në vendet e huaja. Ky disertacion sjell njohuri të reja në përputhje me studimet ekzistuese, dhe hedh dritë mbi proçesin e adaptimit të migrantëve të brendshëm në Shqipëri, dallimet gjinore dhe midis brezave, rëndësinë që kanë burimet sociale, ekonomike dhe ato individuale, rëndësinë e kohëzgjatjes e qëndrimit në destinacionin e zgjedhur si dhe të gërshetimit ndërmjet migrimit të brendshëm dhe atij të jashtëm.

Analizat e këtij studimi janë bazuar në një përfaqje etnografike dhe në material kualitativ të mbledhur gjatë periudhës kohore 2008-2009. Metodika e përdorur për këtë studim përfshin intervista të hollësishme, observime, metoda vizuale, biseda jo formale dhe ditat e punës në terren. Qëllimi i aplikimit të kësaj metodologjie ka qenë eksplorimi i eksperiencave dhe i perceptimeve të migrantëve. Puna në terren u zhvillua në disa zona në Bashkinë e Kamzës.

Duke përdorur modelin bazuar mbi burimet si dhe konceptin teorik të kohëzgjatjes së qëndrimit isha në gjëndje të kuptoja kompleksitetin dhe nivelet e ndryshme të adaptimit të migrantëve të brendshëm. Argumentoj se migrantët e brendshëm kanë nevojë për burime individuale, materiale, sociale dhe kulturore në mënyrë që të plotësojnë nevojat dhe qëllimet e tyre. Vendosja sipas origjinës dhe lidhjeve fisnore përbën dhe burimin kryesor social i cili krijon një sistem mbështetës për migrantët e brendshëm. Sa më gjatë të kenë qëndruar migrantët në destinacionin e zgjedhur aq më i fortë dhe i plotë është adaptimi i tyre. Për më tepër, siguria ekonomike si dhe dëshira për tu adaptuar e ndihmojnë së tepërmi këtë proçes. Gjithashtu femrat dhe gjeneratat e reja perceptohen si më mirë të adaptuar. Në përgjithësi vihet re një fuqizim i migrantëve, fuqizim i cili është zhvilluar me kalimin e kohës dhe është ndihmuar nga eksperiencat e komunitetit të migrantëve. Gjithsesi, ndërkohë që migrantët ndihen gjithmonë e më tepër të adaptuar brenda komunitetit dhe mjedisit të tyre ata ende nuk ndihen pjesë e qytetit. Në këtë mënyrë adaptimi i tyre në një kontekst më të gjerë është ende një proçes në zhvillim.

Migrimi i brendshëm sidomos ai rural-urban, është potencialisht një proçes emancipues për migrantët qofshin këta meshkuj apo femra. Gjithsesi për të përfituar maksimalisht nga ky proçes, në Shqipëri duhen implementuar politika në të cilat përfshihen problemet gjinore, politika të cilat do të përmirësonin situatën e femrave në veçanti por dhe kushtet sociale dhe ekonomike të gjithë migrantëve në përgjithësi. Për më tepër migrimi i jashtëm i kombinuar me

atë të brendshëm, me kohë ka arritur të krijojë një sistem sigurie nga pikpamja ekonomike dhe ajo sociale për migrantët e brendshëm. Migrimi i jashtëm vepron si një burim zhvillimi dhe shprese për të ardhmen për migrantët e brendshëm, por njëkohësisht ka krijuar dhe varësi ekonomike për familjet e këtyre emigrantëve. Të ardhurat sociale dhe financiare nga emigrantët janë jo vetëm një mënyrë jetese për migrantët e brendshëm por dhe një sistem mbrojtës për atë komunitet.

Së fundi, procesi i adaptimit të migrantëve të brendshëm nuk mund të jetë përgjegjësia e vetëm një aktori, qoftë ky komuniteti i migrantëve, autoritetet lokale apo shteti. Ekziston nevoja për një bashkëpunim midis niveleve të ndryshëm, mikro, te mesëm dhe makro me qëllimin e adaptimit të një qasje sa më gjithpërfshirëse.